



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT

OPŠTINA LIPLJAN

MUNICIPALITY OF LIPJAN

### DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

<b>DATË /A</b>	<b>07.05.2017</b>
<b>REFERENCË</b>	
<b>PËR:</b>	<b>z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan</b>
<b>CC:</b>	<b>z. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës në Lipjan</b>
<b>NGA:</b>	<b>z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit të Arsimit në Lipjan</b>
<b>LËNDA:</b>	<b>Raport i punës - Muaji Prill 01.04.2017-30.04.2017</b>

DKA në Lipjan si çdo muaj edhe gjatë muajit Prill ka kryer punë dhe detyra të ndryshme.

Kemi filluar me përgatitjet teknike për testin e Arritshmërisë dhe janë caktuar administruesit dhe qendrat e testimit, ndërsa për Maturën Shtetërore me kërkesë të MASHT-it është caktuar koordinatori në nivel Komune i cili do të merret me mbarëvajtjet e testit të Maturës Shtetërore.

MASHT ka paraparë që nga muaji shtator i këtij viti të gjitha shkollat të fillojnë me ndryshimet kurrikulare, e lidhur me këtë ka filluar trajnimi për mësimdhënësit parafillor, klasa e parë, klasa e gjashtë dhe klasa e dhjetë, për fushat: Gjuhët dhe komunikim, Shkencat Shoqërore, Shkencat Natyrore, Matematikë, Klasa e parë dhe Edukim Fizik.

Inspektimi i punës së personelit arsimor dhe kontrollimi i dokumentacionit pedagogjik në: Shfmu "Hasan Zyko Kamberi" në Sllovi, Shfmu "Skenderbeu" në Kraishtë, Shfmu " Vezir Kolshi" në Baicë dhe SHML Gjinnazi "Ulpiana" në Lipjan.

Kanë filluar ligjeratat në Programin e Avancimit të Pedagogëve një grup i mësimdhënësve nga Komuna jonë.

Është bërë pranimi i donacionit nga Zvicra me pajisje shkollore: Banka, karrika, tabela, kompjuter dhe pajisje të tjera të nevojshme për shkolla.

Kërkesë drejtorëve të shkollave në të cilën kërkesë i kemi njoftuar rreth ndryshimeve të procedurave për pushimet e lehonisë, pushimet mjekësore, pushimet pa pagesë ,zëvendësimet dhe pensionimet dhe është kërkuar zbatimin e kërkesës në fjalë.

## **Kërkesë Departamentit të Prokurimit për zhvillimin e procedurës së prokurimit për:**

- Furnizimin me ujë të thjeshtë për test të semimaturës dhe maturës shtetërore,
- Shtypjen e revistës shkollore për Shfmu “Fehmi Agani” në Medvec,
- Kryerjen e transportit të nxënësve për semimaturë, në relacionin shkollë Lipjan dhe anasjelltas,
- Ushqim dhe pije për administruesit në testin e semimaturës,
- Pagesën e shpeditonit për donacionin e pranuar nga Zvicra,
- Rregullimin e oborrit në Shfmu “Migjeni” në Rufe i Ri dhe Shfmu “Hasan Prishtina” në Llugaxhi,
- Furnizimin e shkollave me dru për vitin shkollor **2017/2018**,
- Furnizimin e shkollave me thëngjill për vitin **2017/2018**,
- Rregullimin dhe renovimin e shkollave në: Shfmu “Dy Dëshmorët” në Dobrajë e Madhe, Shfmu “Migjeni” në Rufe i Ri, Shfmu “Ernest Koliqi” në Babush i Muhaxherëve dhe Shfmu “Haradin Bajrami” në Magure, p.n.f në Blinajë.

Pjesëmarrja në takimin e organizuar nga Asociacioni i Komunave me drejtorët Komunal të Arsimit, në të cilin takim janë diskutuar çështjet e Inspektoratit të punës, pushimet e lehonisë, pushimet mjekësore, pagat pas pensionimit të mësimitdhënësve, mësimitdhënësit me probleme shëndetësore, Udhëzimet Administrative dhe Vendimet mbi programet e kolegjeve private.

Nënalokimi në të gjitha kategoritë ekonomike: Paga dhe mëditje, mallra/shërbime dhe komunal.

## **Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe ate:**

- Formular për ndryshime – kthim nga lehonja, kalimim në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim – skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme - ndërrim i xhirollogarisë.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.